



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3134/ 6 prot.

Datë 26/01/2024

V E N D I M

Nr. 100/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26/01/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër*”, me Nr. REF-81669-09-28-2023, me objekt: “*Blerje pajisje mobilerie për shkollat “Kostandin Kristoforidhi”, shkollën “Onufri” dhe shkollën “Hamit Mullisi”*”, me fond limit 12.367.174 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 23.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Anulimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër*”, me Nr. REF-81669-09-28-2023, me objekt: “*Blerje pajisje mobilerie per shkollat “Konstandin Kristoforidhi”, shkollën “Onufri” dhe shkollën “Hamit Mullisi”*”, me fond limit 12.367.174 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 23.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Ankimues: Operatori ekonomik “KLAME” SHPK, me NIPT K21518003F, me adresë: *Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Elbasan
Adresa: Rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për*

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.09.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër”, me Nr. REF-81669-09-28-2023, me objekt: “Blerje pajisje mobilerie për shkollat “Kostandin Kristoforidhi”, shkollën “Onufri” dhe shkollën “Hamit Mullisi””, me fond limit 12.367.174 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 23.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

II.2. Në datë 23.10.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 23.11.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “KLAME” SHPK	7.955.800 leke	kualifikuar
2. “M. LEZHA” SHPK	11.747.500 leke	kualifikuar
3. “ERALD” SHPK	12.012.000 leke	kualifikuar
4. “ERZENI/SH” SHPK	12.227.770 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 23.11.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit i kërkoi operatorit ekonomik të kualifikuar i pari dhe konkretisht shoqërisë “KLAME” SHPK si në vijim: *“Duke iu referuar procedurës së prokurimit me objekt “Blerje pajisje mobilerie për shkollat “Kostandin Kristoforidhi”, shkollën “Onufri” dhe shkollën “Hamit Mullisi”, me nr. REF 81668-09-2552028 me fond limit 12'367'174 (dymbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, informojmë operatorin ekonomik “KLAME” sh.p.k. me adresë Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.32, Kati i dytë, Tiranë se përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin provues si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës së dorëzuar në rrugë elektronike siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26 të V.K.M-së nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar.*

Rrjedhimisht, jeni të lutur që të paraqisni pranë Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Prokurimeve Publikë, rruga “Petraq Popa”, dokumentacionin e lartpërmendur, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në fotokopje e njëhësuar me origjinalin.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzoni dokumentacionin e kërkuar, brenda fatit përfundimtar ju do të skualifikoheni nga procedura e lartpërmendur.”

II.5. Referuar informacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, konstatohet së në datën 30.11.2023, operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, ka dorëzuar dokumentacionin fizik të kërkuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.6. Në datën 05.12.2023, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht mbi rivlerësimin e ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, si vijon:

1. “KLAME” SHPK	7.955.800 leke	skualifikuar
2. “M. LEZHA” SHPK	11.747.500 leke	kualifikuar
3. “ERALD” SHPK	12.012.000 leke	kualifikuar
4. “ERZENI/SH” SHPK	12.227.770 leke	kualifikuar

II.7. Në datën 05.12.2023, operatori ekonomik “KLAME” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k. në datën 30.11.2023, brenda afatit të përcaktuar, ka dorëzuar dokumentacionin përkatës pasi është njoftuar në SPE, siç parashikohet në pikën 6,

të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Nga verifikimi i bërë është konstatuar se në dokumentet e dorëzuara ka mungesa, konkretisht si më poshtë:

1.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton se ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023, duke mos përmbushur pikën 2.2.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkohet:

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifatat vendore).

2.Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin për mjetin me targë AA 243 HM të marrë me qira e konkretisht :- Kontratën e qirasë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, pra të qiradhënësit, ndërkohe që duhej të ishte për transport të mallrave me qira dhe për të tretë, duke mos përmbushur pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti Teknik dhe profesional, ku kërkohet:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) automjete të përshtatshme për transport me kapacitet mbajtës minimalisht 1.5 ton, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtëm:

Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;

ose

Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatën e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik

3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.

4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

5. Përdorimi nga të tretët përfshin:

a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;

b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;

c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;

d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të tretëve;

e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;

f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”.

Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, certifikata është dhënë në përdorim të vet pronarit të mjetit për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetin e mësipërm do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikatën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Edhe APP në Rekomandimin nr.6732 prot. datë 21.10.2020, rekomandon si më poshtë: Referuar parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët (kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit).

Kur mjetet janë për përdorim nga të tretët, duhet të pajisen me leje transporti që lëshohet për këtë qëllim. Ndërkohë, APP ka konstatuar se operatorët paraqesin në procedurë kontrata noteriale, sipas të cilave kanë marrë me qira mjete, ndërkohë që referuar lejes së transportit, janë për përdorim vetjak dhe jo për përdorim nga të tretët. Rekomandojmë autoritetet kontraktore që të jenë të kujdesshëm gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë dhe të kryejnë verifikimet përkatëse në rast të evidentimit të kontratave të tilla noteriale.

3.Operatori ekonomik ka deklaruar në shtojcën 8 të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit se ka 18 punonjës dhe këtë e vërteton me listëpagesat dhe vërtetimin e tatimeve për sigurimet, por në dokumentacionin e dorëzuar nga OE nuk janë paraqitur listëpagesat e punonjësve

sipas formatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, duke mos përmbushur pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik dhe profesional, ku kërkohet:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 4 (katër) punonjës për muajin e fundit, të vërtetuar me :

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike , ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton për disponueshmerine e stafit, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pari përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

4. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument ku të vërtetojë që nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale, duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në gërmën d) të kriterëve të përgjithshme për kualifikim ku ndër të tjera kërkohet:

Ofertuesi deklaron se:

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale.

Në nenin 82, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në nenin 76, Kriteret detyruese për kualifikim, pika 3 gërma ë) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se:

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Oferta juaj s'kualifikohet për arsyet e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”.

II.8. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 12.12.2023, autoriteti kontraktor pa publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në datën 18.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3690 dhe me nr. 3134 prot., datë 18.12.2023, e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar, si dhe kërkon anulimin e kësaj procedure prokurimi.

II.10. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3134/2, datë 19.12.2023, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe anulimin e kësaj procedure prokurimi.

II.11. Me shkresën nr. 4606/9 prot, datë 29.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 3134/3 prot datë 08.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.12. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit me Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nr. 4606/8 prot, datë 27.12.2023, ka vendosur:

“ [...] ... 1. Për sa i përket pretendimit të OE "KLAME" sh.p.k. se autoriteti kontraktor nuk ka bërë vlerësimin e ofertave brenda afatit 15 ditorë të lejuar nga ligji dhe se për këtë arsye procedura duhet të shpallet e paligjshme, sqarojmë se vonesa ka ardhur për arsye edhe të angazhimeve të tjera që anëtarët e KVO-së kanë, por kryesisht pasi oferta e OE "KLAME" sh.p.k. rezultoi të ishte anomalisht e ulët dhe procedura nga kërkesa e AK për shpjegime, dorëzimi zyrtarisht nga OE i shpjegimeve për ofertën anomalisht të ulët dhe shqyrtimi që komisioni i vlerësimit të ofertave i bëri këtyre shpjegimeve kërkonte kohën e nevojshme. Sa më sipër, nuk ndikoi në një vlerësimin të drejtë dhe të ligjshëm të ofertave të paraqitura.

Edhe OE ankimues nuk pati asnjë pretendim kur solli shpjegimet për ofertën anomalisht të ulët apo kur u kualifikua i pari dhe dorëzoi dokumentet e kërkuara. OE ankimues nuk ka sjellë asnjë fakt sesi ka ndikuar koha e vlerësimit në skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij. Edhe baza ligjore e cituar prej tij nuk parashikon se një akt shpallet i paligjshëm për arsye të ndonjë vonese në shqyrtimin e tij. Për më tepër lind pyetja: a do ta kishte ngritur këtë pretendim OE ankimues nëse do të ishte shpallur fitues apo pse nuk e ngriti kur u kualifikua i pari, por dorëzoi dokumentet e kërkuara?

Sa më sipër, pretendimi i OE "KLAME" ShPK nuk qëndron.

2. Për sa i përket pretendimit se dokumentet për mosdorëzimin e të cilave, OE ankimues është skualifikuar, janë hequr nga dosja me qëllim favorizimin e shoqërisë që vjen pas ofertës sonë, pasi u bisedua me anëtarët e KVO-së dhe u verifikua dokumentacioni i dorëzuar, rezultoi se ky pretendim jo vetëm që nuk qëndron, por është edhe në kufijtë e shpifjes dhe deklarimit të rremë. Personit, i cili dorëzoi dokumentet nga specialistët e prokurimeve me të cilët komunikoi ju tha që të shkonte në zyrën e protokollit ngjitur dhe ti dorëzonte aty dokumentet, por personi i autorizuar nga OE ankimues i la dokumentet në zyrën e prokurimeve, la dhe numrin e telefonit dhe tha tekstualisht: ..."po ju lë numrin e telefonit dhe po pati ndonjë mungesë tek dokumentet me merrni në telefon që t'i plotësojmë, pasi kështu veprojmë edhe me autoritet e tjera kontraktore". Pra siç del edhe nga vetë fjalët e përfaqësuesit të OE ankimues, ky OE dorëzimin e dokumenteve e ka bërë në të njëjtën mënyrë, madje e marrin edhe në telefon nëse mungonte ndonjë dokument, çka bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të parashikuara në LPP e konkretisht nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 1 ku parashikohet: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Në nenin 90 të LPP "Hapja e ofertave" pikat 3 dhe 4 parashikohet:

1. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, në rast se janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

2. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, hapja e ofertave bëhet si më poshtë:

a) autoriteti ose enti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentet e tenderit, sipas rregullave të prokurimit me mjete elektronike;

b) dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit regjistrohet automatikisht në sistem dhe procesi i hapjes nuk ka nevojë të dokumentohet në rrugë shkresore.

Në VKM nr.285, dt. 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar neni 79 "Dorëzimi i ofertave" parashikohet:

Operatorët ekonomike mund të jenë të pranishëm, nëse e kërkojnë, në procesin e hapjes së ofertave.

Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

Në manualin teknik që shoqëron udhëzimin n.7 datë 30.07.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike", i ndryshuar parashikohet:

"Kujdes: Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave, përpara publikimit të njoftimi të fituesit paraprak dhe fillimit të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon operatori ekonomik të kualifikuar i pari të paraqesë nëpërmjet SPE dokumentacion, sikurse parashikohet në nenin 26/6 të VKM, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës së tij në rrugë elektronike, të cilat duhet të paraqiten në origjinal ose kopje të njehsuara me origjinalin."

Konkretisht, autoriteti/enti kontraktor i dërgon operatorit ekonomik fitues me anë të opsionit "Kërkesa", nga llogaria e anëtarit të KVO, kërkesën për paraqitjen e dokumentacionit.

Pra, siç del edhe nga parashikimet ligjore të sipërcituara nuk është parashikuar ndonjë procedurë specifike për dorëzimin e dokumenteve. Dokumentet mund të dorëzohen dorazi ose edhe me postë. Madje edhe prania e OE nuk e pengon hapjen dhe verifikim e dokumentacionit të dorëzuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se të gjitha dokumentet janë paraqitur kopje e njehsuar me origjinalin dhe i janë bashkangjitur vetëm një vërtetimi njësie me origjinalin, nga ku rezulton qartë që nuk ka asnjë dokument të hequr.

Sa më sipër, pretendimi i OE "KLAME" ShPK nuk qëndron.

3. Për sa i përket pretendimit se nga kërkesa e parashikuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik dhe profesional për lejen e transportit është fakultative.

Në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) automjete të përshtatshme për transport me kapacitet mbajtës minimalisht 1.5 ton, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- Aktin e pronësisë së mjetit përkatës; ose
- Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publike (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të tretë për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Dhe sipas legjislacionit në fuqi nëse mjete është në pronësi leja e transportit duhet të jetë për llogari të vet, dhe nëse është me qira leja e transportit duhet të jetë për të tretë dhe me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, parashikohet se: "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse".

Pra, ligji "Për Transportet Rrugore", bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për "Transport për vete" përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për "Transport për të tretë dhe me qira" përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizike a juridike të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, certifikata është dhënë në përdorim të vet pronarit të mjetit për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetin e mësipërm do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikatën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit "Për Transportet Rrugore" është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit "Për Transportin Rrugor".

Edhe APP në Rekomandimin nr.6732 prot. datë 21.10.2020, rekomandon si më poshtë: "Referuar parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretë (kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit).

Kur mjetet janë për përdorim nga të tretët, duhet të pajisen me leje transporti që lëshohet për këtë qëllim. Ndërkohe, APP ka konstatuar se operatorët paraqesin në procedure kontrata noteriale, sipas të cilave kanë marrë me qira mjete, ndërkohë që referuar lejes së transportit, janë për përdorim vetjak dhe jo për përdorim nga të tretët.

Rekomandojmë autoritetet kontraktore që të jenë të kujdesshëm gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë dhe të kryejnë verifikimet përkatëse në rast të evidentimit të kontratave të tilla noteriale.

Për sa i përket pretendimit se për mjetin e marrë me qira nuk lëshohet leje transporti, nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se për mjetin është lëshuar leje për transport mallrash për llogari të vet nga Bashkia Tiranë, pra është mjet transporti, për të cilin lëshohet leje për transport mallrash.

Sa më sipër, pretendimi i OE "KLAME" ShPK nuk qëndron.

Në përfundim të shqyrtimit zyrtari i ngarkuar

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "KLAME" SH.P.K., për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje pajisje mobilerie për shkollat "Kostandin Kristoforidhi", shkollën "Onufri" dhe shkollën "Hamit Mullisi", me fond limit 12'367'174 (dymbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë (pa TVSh). [...]"

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik "KLAME" SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", në të cilin parashikohet se: "1. Komisioni shqyrton ankesën brenda

objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “KLAME” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se: “Operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k. në datën 30.11.2023, brenda afatit të përcaktuar, ka dorëzuar dokumentacionin përkatës pasi është njoftuar në SPE, siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Nga verifikimi i bërë është konstatuar se në dokumentet e dorëzuara ka mungesa, konkretisht si më poshtë:

1.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton se ka paguar taksat dhe tarifën vendore për vitin 2023, duke mos përmbushur pikën 2.2.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkohet:

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifën vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifën vendore).”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.2.3 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifën vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifën vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.”.

III.1.3. Në procesverbalin “Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit”, të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë vijon:

“Kriteri i mësipërm është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.”

III.1.4. Në shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

<ul style="list-style-type: none"> • Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik 			
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>
<p><i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><input type="checkbox"/> <i>ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><input type="checkbox"/> <i>kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</i></p>

<p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>■</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>■</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
- b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
-
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- *Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.*

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e
nevojshme_____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve

<p><i>sqarime nga autoriteti kontraktor.</i></p>	<hr/> <p><i>Makineri e mjete</i></p> <p><i>Po [] Jo []</i></p> <p><i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i></p> <hr/>
<p><i>Emri, Mbiemri</i> _____</p> <p><i>Firma</i> _____</p> <p><i>Vula</i> _____</p> <p><i>Data e dorëzimit të deklaratës</i> _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- ***Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.***
- ***Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.***
- ***Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.***
- ***Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.***

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- ***Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

- **Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.**

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion, si më poshtë vijon:

- *Formularin përmbledhës së vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “KLAME” SHPK datë 23.10.2023.*

III.1.6. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Në nenin 78/2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se:

“2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;*
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;*
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.”.*

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës,

sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “ç” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.8. Në nenin 1 “Objekti i ligjit” të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Objekt i këtij ligji janë taksat e bashkive dhe të komunave”.

Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre”.

Në pikën 7, të nenit 4 të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar”.

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin

publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.10. Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “KLAME” SHPK, si në vijim: “Operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k. në datën 30.11.2023, brenda afatit të përcaktuar, ka dorëzuar dokumentacionin përkatës pasi është njoftuar në SPE, siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Nga verifikimi i bërë është konstatuar se në dokumentet e dorëzuara ka mungesa, konkretisht si më poshtë:

1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton se ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023, duke mos përmbushur pikën 2.2.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkohet:

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifatat vendore).”, si dhe referuar procesverbalit “Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit”, të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit, ku pasqyrohet baza ligjore në të cilën është mbështetur autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri kualifikues, dhe është bazuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së ankimuesit, bazuar në aktet ligjore për taksat dhe tarifatat vendore, KPP sqaron se, Ligji Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në pikën 7, të nenit 4 të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar parashikohet se: “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin Nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Duke iu kthyer kriterit 2.2.3 nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë dokumentet provuese për pagimin e taksave dhe tarifave vendore. Ndërkohë referuar pikës 7, të nenit 4 të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar parashikohet se: “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin Nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Pra, administrimi dhe mbledhja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, është kompetencë e organeve të qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre, ndërsa autoriteti kontraktor ka kërkuar që këto detyrime të përmbushen më anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 8 të dokumenteve standarde të tenderit, e cila nuk parashikon në asnjë rresht të saj në lidhje

me shlyerjen e detyrimit të taksave dhe tarifave vendore, por në pjesa II: Shkaqet e Përfundimit A: deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit: *“operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”*. Në këtë kontekst është e paqartë dhe konfuze mënyra e plotësimit të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, për të vërtetuar shlyerjen e detyrimit të taksave dhe tarifave vendore, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit, duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi, si dhe ky kriter kualifikues është në tejkalim dhe kundërshtim me përcaktimet e nenit 26, pika 2/dh të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, pasi për vërtetimin e faktit se ofertuesi ka paguar taksat dhe tarifave vendore nuk mund të vërtëtohet paraprakisht prej tyre me dorëzimin e Shtojcës 8 *“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”* i publikuar në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Një ndër parimet kryesore të LPP-së, është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, kriteri i mësipërm e ka vendosur në kushte të pabarabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti financiar dhe ekonomik në lidhje me vërtetueshmërinë e shlyerjes së detyrimit të taksave dhe tarifave vendore. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi në mënyrë eksplicite i vërtetimit mbi shlyerjen e detyrimit të taksave dhe tarifave vendore me anë të formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 8 të dokumenteve standarde të tenderit, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar.

III.1.11. Lidhur me pretendimin e ankimesi se: *“... Rezulton se shoqëria jonë ka dorëzuar pranë Institucionit të gjitha dokumentet e kërkuara në kriteret e veçanta të kualifikimit dhe ato të deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Fakti se autoriteti nuk i mori ato me procesverbal, nuk është përgjegjësia jonë. Ishte detyrë e autoritetit kontraktor që të merrte në dorëzim dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria jonë dhe jo të hiqte dokument të caktuar nga dosja. Nga ana tjetër, bazuar në pikën 7 të nenit 26 të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (ndryshuar me Vendimin Nr.710, datë 24.11.2021), që të kërkonte sqarim në lidhje me dokumentacionin e pretenduar se mungonte dhe shoqëria jonë do i'a rivinte në dispozicion edhe njëherë, pasi këto dokumente janë lëshuar përpara datës së dorëzimit të tyre pranë autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor nuk ka bërë transparente marrjen në dorëzim të dosjes me dokumentacionin përkatës. Nuk e ka bërë këtë në prani të përfaqësuesit të shoqërisë sonë, këto në shkelje të dispozitave ligjore të referuara më sipër. Ishte detyrë e autoritetit kontraktor që për të shmangur çdo dyshim në lidhje me dokumentacionin që kishte dosja brenda, që të merrte ato në dorëzim duke mbajtur një procesverbal minimalisht, kopjen e të cilit t'ia vinte në dispozicion edhe përfaqësuesit të shoqërisë. Për këtë arsye, kërkojme anulimin e vendimit që skualifikon shoqërinë tonë.”*, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, KPP vëren parregullsi procedurale lidhur me marrjen në dorëzim nga ana e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të

Ofertave të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues në datë 30.11.2023.

Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në zbatim të hapave proceduralë të përcaktuar në pikën 6, të nenit 26 të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, i ka kërkuar më datë 23.11.2023 operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, i cili ka rezultuar i kualifikuar i pari sipas vlerësimit të datës 23.11.2023, të dorëzonte të gjithë dokumentacionin provues për sa i përket deklarimeve të bëra në Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese pjesë e dokumentacionit të ofertës së dorëzuar prej tij në rrugë elektronike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Referuar informacionit të depozituar me shkresën e autoritetit kontraktor nr. 4606/9 prot., datë 29.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 3134 prot, datë 08.01.2024, bashkëngjitur Vendimi nr. 4606//8 prot, datë 27.12.2023 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK dhe procesverbalet e KVO-së rezulton, se nga shqyrtimi i procesverbalit të datës 05.12.2023 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ku citohet si në vijim: “... *Operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k në datën 30.11.2023, brenda afatit të përcaktuar ka dorëzuar dokumentacionin përkatës, pasi është njoftuar në SPE, siç parashikohet në pikën 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar*”, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur një procesverbal ose çdo dokument provues në datën 30.11.2023, mbi dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Gjithashtu referuar Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nr. 4606/8 prot, datë 27.12.2023 ku citohet se: “2. *Përsa i përket pretendimit se dokumentat për mosdorëzimin e të cilave, OE ankimues është skualifikuar, janë hequr nga dosja me qëllim favorizimin e shoqërisë që vjen pas ofertës sonë, pasi u bisedua me anëtarët e KVO-së dhe u verifikua dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se ky pretendim jo vetëm që nuk qëndron, por është edhe në kufijtë e shpifjes dhe deklarimit të rremë. Personit, i cili dorëzoi dokumentat nga specialistët e prokurimeve me të cilët komunikoi ju tha që të shkonte në zyrën e protokollit ngjitur dhe ti dorëzonte aty dokumentat, por personi i autorizuar nga OE ankimues i la dokumentat në zyrën e prokurimeve, la dhe numrin e telefonit dhe tha tekstualisht: ..."po ju lë numrin e telefonit dhe po pati ndonjë mungesë tek dokumentat me merrni në telefon që t'i plotësojmë, pasi kështu veprojmë edhe me autoritet e tjera kontraktore*”, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk arrin të provojë se operatori ekonomik “KLAME” SHPK nuk ka dorëzuar të plotë dokumentacionin provues lidhur me pagimin e taksave dhe tarifave për taksat vendore, duke e kthyer këtë procedurë në të njëanshme.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e vendosur, **si dhe me transparencën në kryerjen e veprimeve procedurale.**

Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite,

parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, duke i dhënë mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës, **si dhe të garantojë transparencë dhe integritet në kryerjen e veprimeve procedurale.**

III.1.13. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, në përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret e kualifikimit në lidhje me vërtetueshmërinë e shlyerjes së detyrimit të taksave dhe tarifave vendore, janë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, por dhe me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ndaj përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.*

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që procedura e prokurimit objekt-ankimi do të anulohet, shqyrtimi për pretendimet e tjera të palës ankimuese, nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër”, me Nr. REF-81669-09-28-2023, me objekt: “Blerje pajisje mobilerie per shkollat “Konstandin Kristoforidhi”, shkollën “Onufri” dhe shkollën “Hamit Mullisi”, me fond limit 12.367.174 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

